



# UNIVERSITETI I TETOVËS

## FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Studimet e ciklit të tretë të doktoraturës – Biomedicinë

Fakultetit të Shkencave Mjekësore

Këshillit mësimor-shkencor të FSHM-së

Në bazë të vendimit nr. 22-1450/1 të datës 25.05.2022 për vlerësimin e disertacionit të doktoratës të kandidatit **Bekim Ismaili** të miratuar nga **Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës**, u formua **Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoratës të kandidatit Bekim Ismaili në përbërje: Prof. Dr. Fatmir Ferati, Prof. Dr. Nexhbedin Beadini, Prof. Dr. Katarina Stavriç, Prof. Dr. Atilla Rexhepi dhe Prof. Dr. Nevzat Elezi.**

Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoratës pas shqyrtimit të kërkesës të Kandidatit **Bekim Ismaili** paraqet këtë:

### RAPORT

për vlerësimin e punimit të doktoratës të kandidatit **Bekim Ismaili** me titull: *“Ndikimi i kontrollit të diabetit në cilësinë e jetës si dhe në parandalimin e shfaqjes së komplikimeve nga diabeti”*

Punimi i disertacionit të kandidatit sikurse në aspektin strukturorë ashtu edhe në atë përmbajtësor i përmbush të gjitha kriteret për një punim të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi është i konceptuar në në Kapituj dhe Nënkapituj dhe gjithësejt përmban 152 faqe, 33 grafikone dhe 15 tabela.

### **Lënda e hulumtimit**

Lënda e hulumtimit që kandidati ka hulumtuar dhe shtjelluar në punimin e tij të doktoratës, ka rëndësi të madhe shkencore dhe praktike për shkak të nevojës për vlerësim të kualitetit të jetës tek personat diabetik si dhe qasje gjithpërfshirëse në kujdes dhe trajtim të të sëmurëve diabetik.

Diabeti paraqet një sfidë për sistemet shëndetësore në botën perendimore dhe shtetet në zhvillim, kryesisht për shkak të rritjes së obesitetit, popullatës së moshuar dhe mënyrës sedentare të jetesës. Paraqet një gjendje kronike që vendos kufizime serioze në aktivitetet e përditshme të pacientit. Ndryshimi i stilit të jetesës së bashku me paraqitjen e komplikimeve të diabetit, janë ndër faktorët kryesor që ndikojnë kualitetin e jetës së personave diabetik.

Studime të shumta tregojnë se prevalenca e diabetit në popullacionin botëror dhe në vendin tonë vazhdimisht shënon rritje. Poashtu shumë studime botërore theksojnë rëndësinë e kualitetit të jetës tek personat e prekur nga kjo sëmundje.

### **Qëllimi i punimit**

Përmes këtij punimi të doktoratës, kandidati ka bërë matjen e ndikimit të kontrollit të diabetit në cilësinë e jetës dhe shfaqjes së komplikimeve nga diabeti. Këtë vlerësim kandidati e ka realizuar duke analizuar faktorët demografik dhe socio-ekonomik të pacientëve, duke analizuar rezultatet laboratorike si dhe duke matur ndikimin plotësues të tyre në kualitetin e jetës përmes vlerësimit psikometrik me pyetësorë të standardizuar (Diabetes D-39).

Qëllimet sekondare të shtjelluara në këtë punim janë:

- Vlerësimi i kualitetit të përgjithshëm të jetës së pacientëve diabetikë
- Vlerësimi i ndërlikimit në mes të komorbiditeteve dhe kualitetit të jetës
- Vlerësimi i ndikimit të kohëzgjatjes së sëmundjes në kualitetin e jetës së personave diabetikë

- Vlerësimi i ndikimit të llojit të terapisë në kualitetin e jetës së personave diabetikë
- Vlerësimi i ndikimit të nivelit të arsimit dhe të ardhurave mujore në kualitetin e jetës së pacientëve diabetik.
- Vlerësimi i rolit parashikues i parametrave të ndryshëm në përcaktimin e kualitetit të jetës së pacientëve diabetikë

Studimi u parapri nga disa hipoteza edhe atë:

- Hipoteza 1: Kontrolli i mirë i diabetit rezulton në kualitet më të mirë të jetës dhe parandalon shfaqjen e komplikimeve nga diabeti.
- Hipoteza 2: Prania e më tepër komorbiditeteve rezulton në kualitet më të keq të jetës.
- Hipoteza 3: Kualiteti i jetës është në korrelacion me nivelin e arsimit. Individët e paarsimuar kanë kualitet të jetës (QoL) më të keq në raport me individët me arsim të lartë.
- Hipoteza 4: Kualiteti më i mirë i jetës është te personat që jetojnë në qytet
- Hipoteza 5: Terapia insulinike vështirëson kualitetin e jetës së personave diabetikë.

### **Metodologjia e hulumtimit**

Studimi i kandidatit është i llojit Cross Sectional dhe është realizuar në mostër të pacientëve të sëmurë me T2DM, banorë të përhershëm të Tetovës dhe rrethinës. Kampioni i mostrës prej 373 pjesëmarrësve në studim është marrë nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve me T2DM në këtë rajon. Prej pjesëmarrësve 214 ishin të gjinisë femërore (57,37%), ndërkaq 159 ishin të gjinisë mashkullore (42.63%). Kandidati ka përmendur qartë kriteret për përfshirje të pacientëve në studim dhe kriteret përjashtuese. Hulumtimi është realizuar gjatë viteve 2019 – 2021.

### **Rezultatet e hulumtimit**

Me qëllim shqyrtimin e cilësisë së jetës, te të gjithë pacientët e mostrës, përveç aplikimit të pyetësorit të standardizuar Diabetes-39 (D-39), kandidati Bekim Ismaili ka shqyrtuar edhe

dokumentacionin përkatës mjekësor, dhe janë bërë ekzaminime laboratorike. Në rezultatet e fituara janë përfshirë edhe ekzaminimet klinike të këtij studimi.

Analiza sipas karakteristikave të përgjithshme të mostrës ka të bëjë me 6 parametra si: 1) gjinia; 2) mosha; 3) nacionaliteti; 4) vendi i banimit; 5) niveli i arsimit dhe 6) të ardhura mujore të personave të anketuar të përfshirë në hulumtim.

Në kuadër të hulumtimit, është kryer analiza për personat e anketuar me T2DM nga mostra në lidhje me përzgjedhjen e veseve/sjelljeve të tyre. Analiza sipas veseve/sjelljeve përfshiu 5 parametra si: 1) pirja e duhanit; 2) konsumimi i alkoolit; 3) aktiviteti fizik; 4) konsumimi i ëmbëlsirave dhe 5) konsumimi i yndyrnave.

Në analizë, janë përpunuar të dhënat anamnesticke të personave të anketuar me T2DM të grumbulluara nga hulumtuesi si edhe nga dokumentacioni mjekësor. Të dhënat kanë të bëjnë me 6 parametra si: gjatësia (cm), pesha (kg), BMI, parametri i belit (cm), tensioni sistolik (mmHg), dhe tensioni diastolik (mmHg).

Përveç kësaj në rezultatet e analizës janë të përfshira karakteristikat klinike të personave të anketuar nga aspekti i historisë së T2DM dhe atë: a) kohëzgjatja; b) lloji i terapisë; dhe c) prania e komorbiditeteve, numri dhe lloji i tyre (dhimbje gjoksi, goditje truri, lodhje, probleme me veshkat, probleme me shikimin, probleme me qarkullimin etj.).

Në fund është kryer analizë e 4 parametrave kuantitativë laboratorikë (glukoza në gjak (mmol/L), HbA1c (%), trigliceride (mmol/L), dhe kolesteroli (mmol/L) të fituar nga pacientët me T2DM të mostrës.

Për vlerësim të cilësisë së jetës (QOL) të pacientët me T2DM nga mostra është aplikuar pyetësori i standardizuar Diabetes-39 (D-39) me 39 pyetje të grupuara në 5 domene si: a) Domeni I – Energjia dhe mobiliteti (lëvizshmëria) (Energy and mobility) - 15 pyetje; b) Domeni II – Kontrolli i diabetit (Diabetes control) - 12 pyetje; c) Domeni III – Anxhë dhe shqetësim (Anxiety and worry) - 4 pyetje; d) Domeni IV - Barra sociale (Social burden) - 5 pyetje; dhe e) Domeni V - Sjellja seksuale (Sexual behaviour) – 3 pyetje. Të gjitha 5 domenet e pyetësorit D-39 janë përpunuar me aplikimin e shkallës me shtatë nivele të Likertit (Likert-type scales) të përgjigjeve të mundshme të koduara nga 1=aspak i afektuar, deri në 4=mesatarisht i afektuar deri në 7=shumë i afektuar.

## **Rëndësia shkencore**

Sëmundja e diabetit vazhdon të konsiderohet epidemi e kohës moderne. Qëllimi kryesor në luftimin e kësaj epidemie është mirëqënia dhe kualiteti i jetës tek personat e sëmurë. Studimet e ngjajshme në vendet e zhvilluara botërore kontribuojnë në krijimin e politikave shtetërore për menaxhim dhe trajtim më të mirë të sëmundjeve.

Edhe pse në vendet e zhvilluara kualitetit të jetës në përgjithësi dhe kualitetit të jetës të varur nga sëmundja i jepet një rëndësi e veçantë, në vendet në zhvillim kjo problematikë është ende e patrajtuar. Ky studim është i pari në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili mat kualitetin e jetës së personave me T2DM dhe analizon ndikimin e faktorëve shoqëruar të sëmundjes në kualitetin e jetës si dhe në paraqitjen e komplikimeve nga T2DM.

Ky studim ka rëndësi të madhe shkencore pasi që përvec aspektit klinik, vendosën theks të vecantë në aspektin jetësor dhe social të personave të prekur nga kjo epidemi.

Kandidati Bekim Ismaili në kapitullin e Diskutimit, rezultatet e fituara i krahason me punime të ngjajshme të realizuara në vende të tjera duke theksuar ngjajshmërinë dhe dallimet e rezultateve nga punimi i tij në raport me punimet e tjera.

Në fund kandidati bazuar në rezultatet e tij jep rekomandime për mjekësinë preventive primare dhe për politikën shëndetësore publike.

## **Përfundim**

Komisioni vlerëson se punimi i doktoratës me titull “Ndikimi i kontrollit të diabetit në cilësinë e jetës si dhe në parandalimin e shfaqjes së komplikimeve nga diabeti” nga kandidati Bekim Ismaili i plotëson kushtet e parapara sipas statutit të Universitetit të Tetovës dhe Rregullores për Studime të Doktoratës të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë Universitetit të Tetovës që ta miratojë pozitivisht këtë punim të disertacionit të doktoratës.

Anëtarët e Komisionit:

1. Prof. Dr. Fatmir Ferati

---

2. Prof. Dr. Nexhbedin Beadini

---

3. Prof. Dr. Katarina Stavriç

---

4. Prof. Dr. Atilla Rexhepi

---

5. Prof. Dr. Nevzat Elezi

---